WÜRTH



WÜRTH PERFECTION LINE

ushqeni pasionin !

1 MIRËMBAJTJA E JASHTME 4 – 31

Para-pastrimi dhe para-trajtimi 6 – 7
Seria e re e leckave prej argjile 8 – 9
Pastrimi i disqeve të rrotëve 10 – 11
Pastrimi i veturës 12 – 13
Polirimi dhe mbrojtja, diagramet 14 – 16
Shpuzat poliruese, disqet, poliri 18 – 26
Makinat poliruese EPM 160-E dhe EPM 2000-7 28 – 31

2 MIRËMBAJTJA E BRENDSHME 32 – 45

Pastrimi i thjeshtë dhe kujdesi 34 – 36
Pastrimi i xhamave, ekraneve dhe kabinës 37
Absorbenti i pluhurit dhe papastërive 38 – 39
Pastrimi i ndenjëseve të veturës 40 – 41
Mirëmbajtja dhe kujdesi i lëkurës 42 – 43
Dezinfektues për brendësi të veturës 44 – 45

3 PRODUKTE SHTESË 46 – 63

Shishe me spërkatëse 48 – 49
Mbrojtje personale 50
Pastrim dhe kujdes për duar 51
Pastrues dhe aksesorë pastrimi 52 – 53
Lecka pastruese dhe për polirim 54
Tampon për polirim 55
Mirëmbajtje dhe mbrojtje 56
Makina dhe fshesa elektrike 58 – 59
Mbulesa për ndenjëse dhe mbështetëse 60 – 61



WÜRTH PERFECTION LINE

ushqeni pasionin !

Të nderuar Zonja / Zotërinjë, i dashur klient,

Një gjë kemi të përbashkët, dashurinë dhe pasionin për veturat. Prandaj, jam i kënaqur të them se kompania Würth, me produktet e veta cilësore dhe të sigurta, ka qenë një partner i rëndësishëm në industrinë e automobilëve për vite me radhë. Ne mund të krenohemi me këtë traditë, pasiqë tërë këto vite, asnjëherë nuk kemi larguar vëmendjen nga nevojat tuaja. Ne vazhdimisht kemi avancuar më tej produktet dhe shërbimet tona, ashtuqë këtë pasion ta shndërrojmë në vlerë të shtuar.

Ushqeni pasionin! Kjo është saktësisht arsyeja pse ne kemi punuar që ta bëjmë më të lehtë dhe më atraktive gamën përgatitore për veturat. Rezultati: "Würth Perfection Line" , portofolio e produkteve e harmonizuar me kujdes, që ofron performansë të jashtëzakonshme për klientelën e kualitetit Würth!

Tani, Ju gjithashtu mund të përfitoni nga gama e produkteve e përzgjedhur nga rezultatet dhe të siguroni punë shtesë për kompaninë tuaj falë trajtimit profesional për auto.

Würth Perfection Line ju ofron jo vetëm produkte të shkëlqyeshme, por gjithashtu, falë shërbimeve dhe përkrahjes për tregun e caktuar, një vlerë të shtuar për krijimin e konceptit të përkryer.

Ne jemi të bindur se me këtë hap ne do të kënaqim kërkesën tonë - dhe më e rëndësishmja, tuajën - për rezultate të përkryera. Hedhni një sy linjës tonë të re të preparateve për auto dhe zbuloni nga e para pasionin tuaj mbi auto-kozmetikën.

Përshëndetje të përzemërta,

I juaji,

Patric Sattler
Drejtor i divizionit Auto, WÜRTH



1 | MIRËMBAJTJA E JASHTME

Shkëlqim i përkryer

E përkryera është çështje e detalit. “Würth Perfection Line” ju ofron produktin e përkryer për secilën fazë të pastrimit dhe mirëmbajtjes së veturës tuaj - frymëzohu!

PARA-TRAJTIMI INTENZIV ËSHTË THEMELI I PASTËRTISË SË PËRKRYER

Informatë

Për rezultate të përkryera pastrimi, është me rëndësi që së pari të vlerësojmë gjendjen momentale të sipërfaqes. Ne ju rekomandojmë që fillimisht të shpëlani veturën me ujë, për të hequr papastërtinë e madhe. Vetëm atëherë, ju mund të përqendroheni në punën konkrete - vlerësimin e zonave problematike.

Dokumentoni gjendjen e veturës në këtë fazë – evidentim për klientin dhe si listë punësh për hapat vijues të pastrimit.

Para-pastrimi i zonave problematike

Shenjat e insekteve
Pjesa e përparme e veturës dhe xhami i përparmë në veçanti, ndikohen nga shenjat e insekteve. Proteinat e forta të mbetura nga insektet të cilat digjen nga dielli, pjeken në folien e sipërfaqes dhe nuk mund të heqen nga autolarja e zakonshme. Një zgjidhje efektive për para-pastrim të zonave me problem të tillë ofrohet nga produkti jonë
Pastrues i shenjave të insekteve, 500ml*| **Nr. Art: 893 470**.

*Në dispozicion edhe në sasitë:
5 litra | Nr. Art: 893 470 5
20 litra | Nr. Art: 893 470 20



Shpallni luftë shenjave të proteinave:
Spërkatni me "larguesin e insekteve" në zonat e prekura dhe prisni të veprojë.



KËSHILLË

Për rezultat efektiv dhe më të shpejtë, ju rekomandojmë përkrahje mekanike nga produktet tona inovative të **mjeteve prej argjile** në faqe 8 dhe 9. Këto produkte kombinojnë fuqinë pastruese të argjilës me përparësitë e aplikimit të shpuzës, dorezave dhe leckave!



Mënyra e thjeshtë për të hequr njollat e katranit, shtresën e ndryshkut (zgjyrës) dhe rrëshirën e drunjve

Njollat e katranit
Njollat e katranit janë ndër llojet më të këqija të papastërtive, sidomos në pragun anësor dhe disqet e rrotëve - e posaçërisht në makinat me ngjyrë të çelë. Në këto raste përdorni **Pastrues i katranit***| **Nr. Art: 0890 26 005**, fillimisht duke e lënë të veprojë në vendet e njollosura më gjatë.

*Në dispozicion edhe në sasinë:
300ml | Nr. Art: 0890 26

Shtresa e ndryshkut
Würth **Pastrues i shpejtë i ndryshkut të sipërfaqeve, 5L**
| **Nr. Art: 0890 130** heqë shtresën e ndryshkut (zgjyrës) nga trupi i makinës. Thjeshtë aplikojeni në sipërfaqe dhe leni të veprojë për tre minuta më së shumti dhe shpërlajeni mirë me ujë.

Rrëshira e drunjve
Heqë depozitat e rrëshirës së drunjve dhe shenjat e thara. Trajtoni vendet e njollosura me një leckë të njomur në **Pastrues i rrëshirës së pemës, 5L**
| **Nr. Art: 0890 21 005**, ose spërkatni drejtë në sipërfaqe dhe leni të veprojë. Pastaj pastrojeni me shpuzë ose me leckë mikrofibër.

RISI!





Para, gjatë dhe pas përdorimit:
Rezultatet më efektive para-pastruese arrihen me përdorimin e produkteve tona prej argjile, të cilat kombinojnë fuqinë pastruese të argjilës solide me ato të dorezave, shpuzës dhe leckës pastruese.



INOVACIONE TË PËRKRYERA KUNDËR NJOLLAVE

Seria e re e leckave prej argjile, sfungjerëve, dorezave dhe shpuzave

Seria e re dhe shumë inovative e produkteve prej argjile zëvendëson praktikën e zakonshme të përdorimit të argjilës së ngurtë ose shpuzës për heqje të instekteve. Kjo seri kombinon fuqinë pastruese të argjilës së ngurtë me përparësisë e shpuzës, dorezave dhe leckave! Këto produkte ju mundësojnë pastrimin e shpejtë dhe të lehtë të sipërfaqeve - përgatitje e përkryer për fazat pasuese të shpërlarjes dhe polirimit.

Sfungjer argjile D150mm | Nr. Art: 0585 300 150
Doreza argjile | Nr. Art: 0585 300 210
Leckë argjile | Nr. Art: 0585 300 320
Sfungjer argjile | Nr. Art: 0585 300 110





Cilëndo që përdorni; shpuzën poliruese, dorezat ose leckën pastruese:
paraprakisht sipërfaqja duhet të jetë e lagur ashtuqë produktet e përmendura të rrëshqasin më mirë dhe të heqin më lehtë papastërtitë. Ne rekomandojmë ujin, ose si alternativë **Pastrues universal R1 *| Art. No. 0893 125 005** duke e aplikuar me shishen-spërkatëse për të lagur sipërfaqen gjatë procesit të pastrimit.

*Në dispozicion edhe sasitë:
20 litra | Nr. Art: 0893 125 020
60 litra | Nr. Art: 0893 125 060







Pastruesi i diskut të rrotës heq zgjyrën e liruar nga frenat:
Thjesht spërkatni diskun dhe vëreni me kujdes kohën e nevojshme që i nevojitet për të vepruar dhe të ndryshojë ngjyrën në të kuqe.

Disqet shumë të ndotura duhet të trajtohen edhe mekanikisht me furçë dhe të shpëlahen me ujë të pastër.



Shkëlqen sikur e re:
Pas pastrimit përfundimtar të veturës, disqet e rrotëve (felget) janë tërësisht të pastërta dhe plot shkëlqim.



SHKËLQIM I PËRKRYER NË DISKUN E RROTËS (FELGE)

Pluhuri i frenave
Pluhuri i frenave që bie mbi disqet e rrotëve (felge) është problemi më i zakonshëm, por edhe lloje tjera të papastërtive gjithashtu i humbin shkëlqimin veturës prandaj nevojitet trajtim i veçantë. Meqë sipërfaqet e disqeve të rrotëve, viteve të fundit janë sofistikuar dukshëm, ne ju rekomandojmë
Pastrues për diskun e rrotës, PREMIUM, 400ml* | **Nr. Art: 0893 476 500**.
Nuk përmban acid prandaj është i përshtatshëm për të gjitha sipërfaqet e diskut të rrotës.

*Në dispozicion edhe:
5 litër | **Nr. Art: 0893 476 505**
20 litër | **Nr. Art: 0893 476 520**

Ndryshimi i ngjyrës gjithashtu tregon kohëzgjatjen optimale që duhet pritur të veprojë pastruesi.
Për të përmirësuar edhe më tej efektin pastrues nga papastërtia e madhe, ne ju rekomandojmë edhe veprimin mekanik me anë të:
Furçë për pastrim të diskut të rrotës | **Nr. Art: 0891 350 211**.





KËSHILLË

Mbron dhe shkëlqen: Shkumë për goma
Shkumën në goma e aplikoni pasi të keni përfunduar të gjitha pastrimet dhe punët tjera në makinë **Shkumë për goma të veturës, 500ml** | **Nr. Art: 0890 121** dhe leni të veprojë. Përsëritja e procedurës do ti bëjë gomat të duken si të reja. Në fund, fshini gomat me leckë të pastër.

ME TË PËRFUNDUAR PUNËT PËRGATITORE – PASTROJMË VETURËN

Pastrimi klasik i veturës duke përfshi para-pastrimin kërkon shampon, kovë, një **Dorezë për pastrim të veturës, e gjelbër** | **Nr. Art: 0899 710 005** dhe shumë ujë. Sa i përket shamponit ne ju rekomandojmë **Shampon për larje të veturës, AutoshamTWO, 1L*** | **Nr. Art: 0893 010 0**. Pastron dhe mbron ngjyrën – zgjidhje e përkryer për pastrim të shkëlqyer dhe si parapërgatitje për polirim.

*Në dispozicion edhe:
5 litër | **Nr. Art: 0893 010 05**.

Si alternativë për shampon për larje të veturës AutoshamTWO, është:
1 litër | **Nr. Art: 0893 012 0**
5 litër | **Nr. Art: 0893 012 05**



KËSHILLË

Së pari pastroni veturën me shumë ujë, nga lart poshtë, duke u fokusuar në zona të vogla me anë të **dorezave**. Ky veprim parandalon përhapjen e grimcave të shkëputura të baltës, të cilat mund të dëmtojnë ngjyrën.

Pastrim dhe mbrojtje, kombinuar:
Shamponi autoshamTWO kombinon të dy veprimet në një veprim të vetëm!





Pastrimi i xhamit të përparmë
Për pamje të përkryer, ju rekomandojmë **ACTIVE, pastrues për xhama të veturës, 500ml*** | **Nr. Art: 0890 25**. Shtesat me koncentrim të lartë, të pastrimit aktivizohen kur plasin fluskat e shkumës. Kjo garanton fuqi pastruese të shkëlqyeshme e cila njëkohësisht është miqësore dhe e butë me materialin.

*Në dispozicion edhe:

5 litër | **Nr. Art: 0890 25 05**
20 litër | **Nr. Art: 0890 25 20**

Tharja
Me anë të **Fshirëse gome për xhama, me dorezë** | **Nr. Art: 0891 350 205**, mund të thani sipërfaqe të mëdha, ndërsa për kontura ju rekomandojmë **Leckë lëkure për xhama** | **Nr. Art: 0899 700 630** dhe në veçanti për xhama: **Leckë për pastrim dhe polirim** | **Nr. Art: 0899 900 150** i cili në lë pas ndonjë vijë apo shenjë.

MADHËSHTIA KURORËZUESE E PREPARATIT – PERFEKSION I NGJYRËS SË MAKINËS

Ne përpiqemi tju ofrojmë fuqi maksimale inovative që tju bëjmë sa më të lehtë përgatitjen e makinës për polirim dhe dyllosje; tani ju mund të gjeni produkte edhë më efikase dhe të harmonizuara në mënyrë të përkryer në linjën Würth Perfection Line.
Rizbuloni pasionin tuaj për rezultate rrezatuese!



P10

Gërvishtje të ashpra
Shpuza e gjelbër ose tamponat

P20

Gërvishtje të ashpra
Shpuza e kaltër ose tamponat

P30

Hologram
Shpuza e portokalltë ose tamponat

P55 Pink

Hologram
Shpuza për polirim, e valëzuar

Lëkura e portokallit
Shpuza e gjelbër ose tamponat

Gërvishtje mesatare
Shpuza e kaltër ose tamponat


Përzgjedhni polirin dhe shpuzat e duhura varësisht nga ashpërsia e gërvishtjeve dhe aplikoni njëtra-jtshëm në lëvizje të kryqëzuar. Përparësitë e shpuzave tona poliruese të reja mund të shihen sa herë që përdorni ato!

Dyllosja e ngjyrës
Shpuza për polirim ose shpuzë e valëzuar për polirim

Pluhuri i bllokuar
Shpuza e gjelbër ose tamponat

Gërvishtje të imëta
Shpuza e kaltër ose tamponat

Gërvishtje të imëta
Shpuza e kaltër



GJENERATA E RE E SHPUZAVE POLIRUESE - TË KRIJUARA PËR PERFORMANSË MAKSIMALE

1 Sipërfaqe me strukturë (merimangë)
Struktura mundëson rritjen e diametrit të shpuzës polirruese, e cila mundëson kapje më të madhe të sipërfaqes. Kjo rezulton me më shumë heqje dhe përdorim më jetëgjatë të pluhurit abrazivë polirues.
Përparësia juaj: fuqi efektive e rritur me konsum minimal.

2 Qendërzimi
Shumica e shpuzave tona polirruese kanë vrimë për qendërzim të shpejtë dhe të lehtë.
Përparësia juaj: rezultat i harmonizuar i polirimit gjithandej.

3 Sfungjer me pore të hapura
Të gjitha shpuzat polirruese janë prodhuar nga sfungjeri i kualitetit të lartë me pore të hapura. Poret e hapura dhe struktura e sipërfaqes eliminojnë nxehtësinë gjatë punës së polirimit.
Përparësia juaj: shkallë e mirë e heqjes së papastërtive e kombinuar me ngritje të vogël të temperaturës (nxehtësisë).


4 Skaje të rrumbullakosura
Shpuzat tona polirruese adaptohen në të gjitha konturat e makinës falë skajeve të rrumbullakosura të tyre. Kjo gjeometri fleksibile parandalon gërvishtjet e reja të ngjyrës nëpër kontura.
Përparësia juaj: fleksibilitet në cilëndo formë të trupit të makinës.

THJESHTËSI QË MUND TA NDJENI – ZBULONI DISQET TONA POLIRUESE 3NË1


Disk polirues 3në1
Disqe polirruese të perfeksionuara për përdorim profesional: Përdorni të tri dimensionet e shpuzave polirruese me vetëm një disk. Kjo mundëson punë shumë të shpejtë dhe efektive për të arritur rezultate të përkryera - madje edhe me përmasa të ndryshme të shpuzave.
Përparësia juaj: Përdorim i thjeshtë, rezultate më të shpejta, vlerë e shtuar.


SË SHPEJTI


3NË1




RISI!













SET I PËRKRYER PËR GËRVISHTJET E ASHPRA

Polir P10

Polir me veprim të shpejtë, abraziv, për heqje të menjëhershme të gërvishtjeve të ngjyrës. Kombinuar me shpuzën e gjelbër poliruese jepë efekt maksimal të heqjes së papastërtisë - rezultate të përkryera!

Polir P10, 250 g | Nr. Art: 0893 150 012
Polir P10, 1 kg | Nr. Art: 0893 150 010

Seria e shpuzave të gjelbra poliruese

Shpuza të forta poliruese për efekt maksimal të heqjes së papastërtive, me ngritje minimale të temperaturës.
Përparësia juaj: punë e lehtë edhe në rastet kur ka gërvishtje të rënda të ngjyrës.


Shpuzë për polirim, e gjelbër 90 x 25 mm | Nr. Art: 0585 025 090
Shpuzë për polirim, e gjelbër 145 x 25 mm | Nr. Art: 0585 025 145
Shpuzë për polirim, e gjelbër 170 x 25 mm | Nr. Art: 0585 025 170

Alternativë
Tampon polirues, i leshtë, ngj. e bardhë, 80 mm | Nr. Art: 0585 23 80
Tampon polirues, i leshtë, ngj. e bardhë, 125 mm | Nr. Art: 0585 235
Tampon polirues, i leshtë, ngj. e bardhë, 150 mm | Nr. Art: 0585 195
Tampon polirues, i leshtë, ngj. e zezë, 135 mm | Nr. Art: 0585 135




RISI!


Gërvishtje të ashpra


Gërvishtje mesatare


Gërvishtje të imëta







PREPARAT I PËRKRYER PËR GËRVISHTJET MESATARE DHE TË IMËTA TË NGJYRËS

Polir P20
Polir mesatarisht abraziv me shkëlqim të lartë për trajtim efikas të ngjyrës. Gërvishtjet mesatare dhe të imëta mund të heqen në mënyrë efikase, në kombinim me shpuzat e kaltërta - për një sipërfaqe të përkryer të ngjyrës.

Polir P20, 250 g | Nr. Art: 0893 150 022
Polir P20, 1 kg | Nr. Art: 0893 150 020

Seria e shpuzave poliruese të kaltërta
Shpuza poliruese të mesme-forta për heqje të mirë të papastërtive, të kombinuara me ngritje minimale të temperaturës.
Përparësia juaj: fortësi e matur, perfeksion maksimal.

Shpuzë për polirim, e kaltër 90 x 25 mm | Nr. Art: 0585 027 090
Shpuzë për polirim, e kaltër 145 x 25 mm | Nr. Art: 0585 027 145
Shpuzë për polirim, e kaltër 170 x 25 mm | Nr. Art: 0585 027 170


Alternativë
Tampon polirues, i leshtë, ngj. e bardhë, 80 mm | Nr. Art: 0585 23 80
Tampon polirues, i leshtë, ngj. e bardhë, 125 mm | Nr. Art: 0585 235
Tampon polirues, i leshtë, ngj. e bardhë, 150 mm | Nr. Art: 0585 195
Tampon polirues, i leshtë, ngj. e zezë, 135 mm | Nr. Art: 0585 135


Polir P55
Kombinim inovativ i polirit për rezultate të shpejta. Mundëson trajtimin dhe dyllosjen (hermetizimin) e sipërfaqeve të ngjyrosura me vetëm një veprim.

Polir P55, 250 g | Nr. Art: 0893 150 056
Polir P55, 1 kg | Nr. Art: 0893 150 055
Polir P55, 5 kg | Nr. Art: 0893 150 058



RISI!









DYSHJA E PËRKRYER PËR MBROJTJE AFATGJATE

Polir P30
Polirurë përfundimtare për heqje të përhershme të vijave dhe hologrameve në ngjyrat e mbyllë-ta. Përdoreni në kombinim me shpuzat ngjyrë portokalli për një shkëlqim maksimal - që do ti lë përshtypje klientit tuaj!


Polir P30, 250 g | Nr. Art: 0893 150 032
Polir P30, 1 kg | Nr. Art: 0893 150 030

Seria e shpuzave poliruese ngjyrë portokalli
Shpuza poliruese të mesme-forta për heqje të mirë të papastërtisë, me ngritje minimale të temperaturës.
Përparësia juaj: fortësi e matur, perfeksion maksimal.


Shpuzë për polirim, e portokalltë, 90 x 25 mm | Nr. Art: 0585 026 090
Shpuzë për polirim, e portokalltë, 145 x 25 mm | Nr. Art: 0585 026 145
Shpuzë për polirim, e portokalltë, 170 x 25 mm | Nr. Art: 0585 026 170



RISI!


Mbrojtje (me politurë finale) e ngjyrës


Gërvishtje minimale


Hologramet







REKOMANDIMI YNË PËR MBROJTJE AFATGJATE

Politurë për fazën finale

Dorë përfundimtare e përkryer - mbrojtje afatgjate me shkëlqim të lartë. Lëmon edhe gërvishtjet më të imëta në ngjyrë dhe lë pas sipërfaqe si pasqyrë. Produkti gjithashtu ofron mbrojtje afatgjate ndaj kushteve klimatike, gërvishtjeve të lavazhit dhe ndikimeve tjera të ambientit. Përdorim i përkryer kur përdoret në kombinim me shpuzën poliruese me ngjyrë të zezë!

Politurë për fazën finale, 250 g | Nr. Art: 0893 011 250
Politurë për fazën finale, 1 kg | Nr. Art: 0893 011 01
Politurë për fazën finale, 5 kg | Nr. Art: 0893 011 05

Alternativë:
Mbrojtës polimer i ngjyrës së veturës | Nr. Art: 0893 158

Shpuzë për polirim, ngjyrë e zezë

Formë ergonomike e prodhuar nga shpuza (sfungjeri) e shpeshtë për izolim efektiv të sipërfaqeve të ngjyrosura dhe atyre plastike. Avantazhi: mund të trajtohen edhe zonat me qasje të vështirësuar!

Shpuzë për polirim, e zezë 130 x 50 mm | Nr. Art: 0585 128 130

Shpuzë për polirim, e portokalltë

Zgjidhje për të gjitha polirimet: Formë e përkryer ergonomike e prodhuar nga shpuza e fortë me pore të imëta për punë manuale me të gjithë llojet e polirëve. Avantazhi: shpuzë për të gjitha polirimet!

Shpuzë për polirim, e portokolltë, 130 x 50 mm | Nr. Art: 0585 126 130

Alternativë:
Shpuzë për polirim, e valëzuar | Nr. Art: 0585 28 130
Tampon polirues, i lehtë, ngj. e zezë, 135 mm | Nr. Art: 0585 135



KËSHILLË

Si sprej kontrollues para dyllosjes ne ju rekomandojmë edhe **IPA pastrues (izopropanol), 500ml | Nr. Art: 0893 223 500**.

UDHËZUES PËR APLIKIM TË POLIRIT

	P10	P20	P30	P55	POLITURË PËR FAZËN FINALE
Produkti	**Polir P10** **Nr. Art: 0893 150 010** **/ 012**	**Polir P20** **Nr. Art: 0893 150 020** **/ 022**	**Polir P30** **Nr. Art: 0893 150 030** **/ 032**	**Polir P55** **Nr. Art: 0893 150 055** **/ 056 / 058**	**Politurë për fazën finale** **0893 011 01** **/ 05**
Fusha e aplikimit	Ngjyrosje Detale	Ngjyrosje Detale	Ngjyrosje Detale	Detale	Detale / blerës fundor
Përdorimi sipas dëmtimit të ngjyrës	Polir shumë abraziv, me shkëlqim të lartë, për heqje të shpejtë të gërvishtjeve pas riparimit ose ngjyrës përfundimtare si dhe për polirim të shenjave të mëdha në ngjyrën e përdorur. Shenjat e rërës të grimcave prej P1500 i heqë me lehtësi.	Polir mesatarisht abraziv, me shkëlqim të lartë, për përgatitje efektive të ngjyrës, heqje të shenjave të rërës dhe gërvishtjeve në ngjyrë si dhe heqjen e papërsosurive në ngjyrën e fortësuar pas riparimit. Shenjat e rërës të madhësisë deri P2000 i heqë me lehtësi.	Polir me shkëlqim të lartë, për heqje të holograme ve, eliminim afatgjatë të vijave dhe holograme ve në ngjyra të errëta (mbyllta) dhe për heqje të shenjave të rërës apo gërvishtjeve të imëta në ngjyrën e vjetër ose të re. Shenjat e rërës të madhësisë deri P3000 i heqë me lehtësi.	Poliri P55 është prodhuar enkas për përdorim në ngjyra të vjetra dhe të reja. P55 mundëson polirim dhe mbrojtje në një trajtim të vetëm. Poliri shquhet me aftësi të lartë heqje dhe shkëlqim të lartë kur lustrohet.	Dylli sintetik dhe polimerët sigurojnë mbrojtje afatgjate dhe shkëlqim briljant. Grimcat e dyllit sheshtohen në teksturën e imët të sipërfaqes së ngjyrës, duke lënë pas sipërfaqe si të pasqyrës me nuancë briljante të ngjyrës. Mund të polirohet nga sipërfaqet e nxehta dhe nuk lë mbetje pas. Nuk përmban silikon.
	Heqja e pluhurit të bllokuar, shenjat e rërës, shenjat si lëkura e portokallit, etj.	**Shenjat e rërës dhe gërvishtjet e imëta mesatare dhe të ashpra.**	**Heqja e holograme ve dhe gërvishtjeve nga autolarja.**	**Shenja të rërës dhe gërvishtje. Restaurim i veturave të përdorura - vjetra.**	**Shkëlqim dhe mbrojtje e ngjyrës.**
Aplikimi	Tundeni mirë kanaçen para përdorimit. Shpërndani njëtrajtshëm polirin në shpuzë si dhe një sasi të vogël mbi sipërfaqen e ngjyrës. Vendosni shpuzën të puthitet mbi sipërfaqen e ngjyrës dhe startoni makinën poliruese. Duke përdorë shtypje të lehtë dhe shpejtësi të rrotullimit prej 1500 deri 2000 trajtoni sipërfaqen deri të heqen shenjat e gërvishtjes në ngjyrë. Veproni kështu pjesë-pjesë nëpër sipërfaqe.	Tundeni mirë kanaçen para përdorimit. Shpërndani njëtrajtshëm polirin në shpuzë si dhe një sasi të vogël mbi sipërfaqen e ngjyrës. Vendosni shpuzën të puthitet mbi sipërfaqen e ngjyrës dhe startoni makinën poliruese. Duke përdorë shtypje të lehtë dhe shpejtësi të rrotullimit prej 1500 deri 2000 trajtoni sipërfaqen deri të heqen shenjat e gërvishtjes në ngjyrë. Veproni kështu pjesë-pjesë nëpër sipërfaqe.	Tundeni mirë kanaçen para përdorimit. Shpërndani njëtrajtshëm polirin në shpuzë si dhe një sasi të vogël mbi sipërfaqen e ngjyrës. Vendosni shpuzën të puthitet mbi sipërfaqen e ngjyrës dhe startoni makinën poliruese. Duke përdorë shtypje të lehtë dhe shpejtësi të rrotullimit prej 1500 deri 2000 trajtoni sipërfaqen deri të heqen shenjat e gërvishtjes në ngjyrë. Veproni kështu pjesë-pjesë nëpër sipërfaqe.	Shpërndani njëtrajtshëm polirin në shpuzë si dhe një sasi të vogël mbi sipërfaqen e ngjyrës. Vendosni shpuzën të puthitet mbi sipërfaqen e ngjyrës dhe startoni makinën poliruese. Duke përdorë shtypje të lehtë dhe shpejtësi të rrotullimit prej 1500 deri 2000 trajtoni sipërfaqen deri të heqen shenjat e gërvishtjes në ngjyrë. Veproni kështu pjesë-pjesë nëpër sipërfaqe.	Pastroni mirë ngjyrën dhe eliminoni gërvishtjet dhe shenjat e ngjyrës me polir. Pastaj aplikoni politurën për fazën finale në shtresë të hollë me sfungjerin e shtypur duke e pritur të thahet pakëz dhe pastaj fshini me leckën mikrofibër.
Përfundimi	Heqni mbetjet e polirit me leckë mikrofibër. Heqni ndonjë vijë me polir P30.	Heqni mbetjet e polirit me leckë mikrofibër	Heqni mbetjet e polirit me leckë mikrofibër	Heqni mbetjet e polirit me leckë mikrofibër	Heqni mbetjet e polirit me leckë mikrofibër
Përpunimi	Mekanik	Mekanik	Me dorë / Mekanik	Me dorë / Mekanik	Mekanik
Shpuza / tamponi i përshtatshëm për polirim					

● Shpuzë për polirim, e valëzuar ● Shpuzë për polirim, e portokallë ● Shpuzë për polirim, e kaltër ● Tampon prej leshi, i zi

WÜRTH PERFECTION LINE

ushqeni pasionin!

E FUQISHME: PROVONI MAKINËN TONË POLIRUESE EKSCENTRIKE


Makina e re ekscentrike për polirim, EPM 160-E është ideale për heqjen e dëmtimeve të ngjyrës. Tërësisht e ridizajnuar ngërthen në vete dizajn kompakt, zhurmë të vogël dhe punë të lehtë.
Mrekulli në kuti të fuqishme, ju vjen nga Würth e që është dizajnuar posçërisht për profesionistë si ju.


Makinë për polirim, ekscentrike, EPM 160-E | Nr. Art: 5707 500 0

Alternativë:
Makinë për polirim P200-E | Nr. Art: 0702 4530

Blehet me të:
Disk mbajtës i shpuzës poliruese M14, 80mm | Nr. Art: 0586 01 80
Disk mbajtës i shpuzës poliruese M14, 125mm | Nr. Art: 0586 01 125
Disk mbajtës i shpuzës poliruese M14, 150mm | Nr. Art: 0586 01 150







E fuqishme: motor 1,010 W
Efektive: goditje polirimi 8 mm për efikasitet të lartë
Fleksibile: Rregullim shpejtësie 160–480 rrot / min
Fuqi kompenzuese: Tahogjeneratori mban shpejtësin konstante edhe kur motori ka ngarkesë.
Siguri: nga rreziku për ristartim; ka mbrojtje për mbingarkesë dhe mbikëçyrje e temperaturës.

Kjo makinë është bërë t'ju inspirojë – përjetoje!

Shpuza poliruese mund të montohet lehtë dhe pa problem në pllakën speciale mbajtëse të njomur. Para se të filloni polirimin, së pari aplikoni polirin në shpuzë. Funksioni i startimit gradual "soft start" mundëson startimin e ngadaltë duke evituar stërpikjen e polirit. Ngasja e vazhdueshme ofron moment të madh force edhe në shpejtësi të ulët. Kjo ju mundëson rezultat polirimi të njëtrajtshëm dhe pa hologram - madje edhe para dorës përfundimtare.

Siguresa e integruar e boshtit garanton lodhje të vogël dhe punë komfore. Dorëza e përparme për mbërthim mundëson përdorim optimal dhe preciz të makinës në të gjitha përdorimet. Dorëza mund të heqet sipas nevojës. Shkalla e ulët e akumulimit të nxehtësisë në sipërfaqen ku vepron shpuza, e bën makinën EPM 160-E ideale për punë në ngjyrat e ndjeshme në nxehtësi. Ndjeni pasionin për të përkryeren që është futur në këtë makinë - do të magjepseni!

MAKINË POLIRUESE PA DRIDHJE - QË PUNA TË JETË ARGËTIM

Makinë e fuqishme për polirim, me dorëz praktike ergonomike në formë elipse.
Punë e qetë: sistemi absorbues i vibrimeve mundëson punë të rehatshme pothuajse pa dridhje.
E shumëanshme: potenciometri i cili rregullon numrin e rrotullimeve mundëson përshtatjen e makinës ashtuqë mund të përdoret për polirim në materiale të ndryshme.
Mirëmbajtje e thjeshtësuar: ndërrimi i brushave të karbonit është shumë i thjeshtë falë kapakut plastik i cili eviton nevojën për hapjen e makinës.

Makinë elektrike për polirim, EPM 2000-7 | 5717 010010



E fuqishme: 1200 W
Numri i rrotullimeve pa ng.: 800 - 1200 rrot/min
Diametri maks. i diskut polirues: 180mm
Pesha: 3.4 Kg
Gjatësia e kabllos: 4m



Ndërrim i lehtë dhe i shpejtë i brushave!

Kapaku i cili heqet shumë thjeshtë, mundëson qasje të drejtpërdrejtë në brushat e karbonit. Kjo eviton hapjen e tërë makinës dhe kështu kursen kohën dhe mundin.



Rregullim i numrit të rrotullimeve!

Tabela me diagramin ju mundëson përzgjedhjen e numrit të përshtatshëm të rrotullimeve, varësisht prej punës - aplikimit që kryeni gjatë polirimit.



2 | MIRËMBAJTJA E BRENDSHME

Kujdes i përkryer

Ju nevojitet produkti i duhur për të mënjanuar të gjitha tipet e papastërtisë dhe për secilën punë.
"Würth Perfection Line" ju ofron linjën komplete të produkteve për mirëmbajtje - kualitet i përkryer për kujdes të thjeshtë por efektiv të enterierit!



Edhe pastrimi i thjeshtë me **Active Clean** jepë pastërti të qartë. Për sipërfaqet speciale si: kabina, xhami i përparmë, pasqyrat, dhe ekranet, ne ju rekomandojmë gjithashtu përdorimin e pastruesve special nga "Würth Perfection Line" të cilët mund ti gjeni në faqet në vijim.







PASTRIMI I THJESHTË DHE KUJDESI: ME PASTRUESIN "ACTIVE CLEAN" DHE PASTRUESIN E PLASTIKËS

Puna e parë gjatë mirëmbajtjes së brendësisë së veturës është heqja e papastërtive të mëdha të pluhurit dhe copave të baltës. Ndenjëset dhe hapësirat tek këmbët fillimisht duhet të pastrohen me thithëse elektrike ashtuqë të heqet dheu, copëzat e baltës dhe shenjat e ujit. Dokumentoni këto shenja për klientin tuaj! Mos filloni me pastrimin e detajuar para se të kryeni këtë hap.

Pastrimi i plotë dhe mirëmbajtja

Kujdesi i përkryer i hapësirës brenda veturës ngërthen pastrimin dhe mbrojtjen në një. Zgjidhja optimale për këtë është produkti **Pastrues i brendshëm për veturë AKTIV-CLEAN** | **Nr. Art: 0893 472**. Kombinim i përkryer i dy hapave: pastrimit të plotë dhe mirëmbajtjes - kursen paratë dhe kohën. Spërkatni Active Clean në leckën mikro-aktive dhe pastroni sipërfaqen. Ky produkt parandalon parregullsitë dhe depozitat e papastërtisë edhe në xhamin e përparmë të makinës gjithashtu.

Alternativë:
Pastrues i brendshëm për veturë F1, 1 litër | Nr. Art: 0890 120
Pastrues i brendshëm për veturë F1, 5 litër | Nr. Art: 0890 120 5

Zonat problematike në dyer

Pjesa e panelit të dyerve dhe pjesa e poshtme ku kemi kontakt gjatë hyrjes janë pjesët më të ndikuara. Përveç akumulimit të baltës, këto janë pjesët me më së shumti gërvishtje. Për freskim afatgjatë të ngjyrës, ne rekomandojmë që këto pjesë fillimishtë ti trajtoni me **Pastrues i plastikës në veturë***| **Nr. Art: 0893 285**. Me këtë veprim ju do të heqni me lehtësi madje edhe papastërtinë e pjekur dhe ti jepni dyerve pamje të sofistikuar.

*Në dispozicion edhe:
5 litër | Nr. Art: 0893 285 5







Produkti jonë **Pastrues-mirëmbajtës i plastikës në veturë** është zgjidhja e përkryer për detajet e enterierit. Thjeshtë spërkatni në leckën mikro-aktive dhe pastroni kabinën.

NE KEMI PASTRUESIN SPECIAL TË PËRKRYER PËR SIPËRFAQET E XHAMIT, EKRANEVE DHE KABINËS

Produkti jonë **Pastrues-mirëmbajtës i plastikës në veturë*** | **Nr. Art: 0890 222 1** është i destinuar për heqje efektive të papastërtisë dhe njëherit mirëmbajtjes së sipërfaqeve të kabinës. Rigjallëron ngjyrën dhe jep shkëlqim mëndafshi, poashtu ka efekt anti-statik duke parandaluar tërheqjen e pluhurit nga sipëfaqja për një kohë.

*Në dipozicion edhe:
20 litër| Nr. Art: 0890 222 20

Produkti praktik **Leckë pastruese për pajisje elektronike, 100 copë| Nr. Art: 0890 150** është zgjidhje e përkryer për pastrim të ekraneve, ndërprerësve dhe pullave të materialeve të ndjeshme në prekje. Leckat e para-nginjura janë anti-statike dhe nuk lënë pas vija.

*** Leckë pastruese për pajisje el. rimbushje, 100 copë| Nr. Art: 0890 150 1**

Produkti **Pastrues për xhama të veturës*** | **Nr. Art: 0890 220 01** është shumë i përshtatshëm për xhamin e përparmë dhe retrovizorin (pasqyrën). Heqë të gjitha shenjat e gishtave, pluhurin, nikotinën dhe njollat e dyllit. Më së miri përshtatet me leckën mikro-aktive të terur.

*Në dispozicion edhe:
5 litër| Nr. Art: 0890 220 02



Xhamat dhe pasqyrat më së miri pastrohen me lecka mikro-aktive dhe me **pastruesin e xhamit** i cili është miqësor me ambientin**.**



KËSHILLË

Ju rekomandojmë përdorimin e leckës mikro-aktive për të kombinuar përdorimin me pastruesit tanë special.

RISI!

Ka ndjesi unike dhe vepron në mënyrë të njëjtë:
Provoni produktin Absorbent i pluhurit dhe papastërtisë.
Pastron vendet që vështirë qasen siç janë grilat e ventilimit brenda në veturë.







PRODUKTI QË ZGJIDH PROBLEMIN - PROVONI ABSORBENTIN E PLUHURIT DHE PAPASTËRTISË

Të gjithë e njohin dhe të gjithë e urrejnë: copëzat e baltës dhe pluhuri në vende vështirë të qasshme. Ne tashmë ju kemi shpallur luftë me **Absorbent i pluhurit dhe papastërtisë.** Vret bakteriet dhe mikrobet. Geli në konsistencë deltine për-shtatet në formë dhe mbledhë papastërtinë edhe në vendet ku qasja me leckë është shumë vështirë. Nuk lë pas ndonjë mbetje - provoje! Ripërdoret: Absorbenti i pluhurit vjen në kuti teneçeje dhe qese.

Absorbent i pluhurit dhe papastërtisë, 150 g | Nr. Art: 0890 900 150











Këshillë: Pajisja "Top Gun" ka efekt nxjerrës i cili ju mundëson heqjen e pluhurit nga stofi (materiali).

PASTRUES I PËRKRYER I NJOLLAVE PËR STOFIN E NDENJËSEVE

Njollat e ujit në stofin e ndenjëseve (ulëset) të veturës

Heqni papastërtinë e madhe me fshesë elektrike, ndërsa njollat e ujit me produktin tonë **Pastrues universal R1** *| **Nr. Art: 0893 125 005**. Fillimisht mbushni **TOP GUN Pistole pastruese pneumatike, Top Gun I** | **Nr. Art: 0891 703 140** ose **Fshesë elektrike për tapiceri, SEG 10 Master | Nr. Art: 0701 110 0** me tretje R1 për pastrim profesional të brendësisë së veturës. Bëni kujdes për raportin e sasisë së tretjes dhe kohës që i duhet për të vepruar.

*Në dispozicion edhe:
20 litër | Nr. Art: 0893 125 020
60 litër | Nr. Art: 0893 125 060

Yndyra (graso), vaji dhe njollat tjera në stofin e ndenjëseve

Produkti jonë **Pastrues i njollave** | **Nr. Art: 0890 211 00** përmban tretës dhe heqë me lehtësi katranin, papastërtinë, vajin, yndyrën, dhe njollat nga stofi. Vlen të përmendet se nuk lë pas ndonjë shenjë nga pastrimi!
Përdoreni në leckë mikro-aktive ose **Leckë tekstili për polirim** | **Nr. Art: 0899 811**.









MIRËMBAJTJE DHE KUJDES I PËRKRYER PËR LËKURËN

Pastrim dhe mirëmbajtje e ndenjëseve prej lëkure

Produkti Würth **Pastrues dhe mirëmbajtës i lëkurës** | **Nr. Art: 0893 012 9** në ndenjëset prej lëkure më së miri aplikohet me fërkim rrethor të leckës mikro-aktive. Përdorimi i rregullt i produktit mban lëkurën e freskët dhe i jep mbrojtjen më të mirë nga ndikimet e jashtme.

Mbrojtje dhe mirëmbajtje

Produkti **Mbrojtës-mirëmbajtës për tekstil** | **Nr. Art: 0893 032 100** është ideal për mirëmbajtje të materialit prej tekstili-stofi në veturat kabriolet. Përveç që mbron nga uji, poashtu i zgjatë jetën e tekstilit-stofit nga i cili është prodhuar.





KËSHILLË

Spreji për mirëmbajtje është superior edhe në mirëmbajtjen e shtrojave prej gome për hapësirën te këmbët në veturë.

DHE...
MBI ËMBËLSIRËN
VIE QERSHIA

Aromë dhe dezinfektues për veturë

Pas pastrimit të brendësisë së veturës, dhe pasi të keni përfunduar me mirëmbajtjen e lëkurës, plastikës gomave etj. është koha të jepni edhe komponentën e fundit por jo më pak të rëndësishme. Produkti jonë Aromë / Dezinfektues për veturë (Quick Fresh Active) përveç aromës së këndshme ka edhe efekt anti-bakterial si dhe ndikim në parandalimin e krijimit të këpurdhave dhe bakterieve.

Aromë/Dezinfektues për veturë, 100ml | Nr. Art: 0893 764 650



Këshilla rreth aplikimit

Gjatë aplikimit të këtij produkti dhe për disa minuta pas, nuk duhet të ketë njerëz brenda veturës.
Të gjitha pajimet elektronike duhet shkyçur gjatë aplikimit.
Shmangni burimet ndezëse (shkëndijat).
Pas aplikimit, vetura duhet ajrosur mirë, leni dyert e hapura për disa minuta.
Mos pini duhan në veturë menjëherë pas aplikimit të sprejit.

1. Fikeni kondicionerin (klimën), aktivizoni vetëm ventilatorin (qarkullimin e ajrit).

2. Ventilatorin e aktivizoni në shpejtësinë maksimale ndërsa temperaturën e rregulloni të fryejë ftohtë.

3. Tundeni kanaçen mirë.

4. Vendoseni kanaçen poshtë në veturë në mënyrë vertikale dhe aktivizoni kokën e sprejit. Dritaret dhe dyert e veturës duhet ti mbani të mbyllura gjatë aplikimit (përafërsisht dy minuta). Sigurohuni që avujt e sprejit të mos drejtohen apo të arrijnë komandat e xhamit të sipërm apo komandat e dritës sipër në veturë.
5. Pas zbrazjes së kanaçes, fshini me një leckë të thatë substancën e tepërt.
6. Ajrosni mirë veturën.







aromë limoni



3 | PRODUKTE SHTESË

Cilësi e përkryer

A është për ju cilësia 100% e rëndësishme edhe nëse duhet blerë produkte shtesë? Nëse po, atëherë ju jeni në vendin e duhur. Në faqet në vijim, ju sjellim disa produkte të cilat do t'ju nevojiten herë pas here gjatë mirëmbajtjes së veturave.



360°

INFO

Sistemi special thithës mundëson spërkatjen në çfarëdo pozite. E përkryer për punë sipër, në këndapo vertikalisht.



SHISHE ME SPËRKATËSE

Shishe me spërkatëse
Dizajn kompakt: ngjyrë natyrale, material që nuk thyhet, nuk rrjedh.
Shenjim i saktë dozimi: 100 mL dhe 200 mL
Identifikim i qartë: etiketa individuale për të shënuar në to përmbajtjen që keni mbushur.

1 litër | Nr. Art: 0891 502 003

Shishe me spërkatëse, 360°
Përdorim i lehtë: koka spërkatëse ergonomike me dorezë të gjatë
Shtypje fleksibile: pipëz rregulluese që mbyllet, pompim - shtypje deri në 15 bar
Dizajn kompakt: transparente, nuk thyhet shishe 0.5 liter me shenja dozuese çdo 100 ml
Identifikim i qartë: etiketa individuale për të shënuar në to përmbajtjen që keni mbushur.

500 ml | Nr. Art: 0891 502 360



Shishe me spërkatëse-pompim 360°
Shishe me spërkatëse për profesionistë, mundëson spërkatje kontinuale në çfarëdo pozite.
Lëvizje maksimale: punon besueshëm edhe sipër (përmbi), në këndose vertikalisht
Stabilitet i mirë: formë konike, dizajn kompakt.
Identifikim i qartë: etiketa individuale për të shënuar në to përmbajtjen që keni mbushur.

1 litër | Nr. Art: 0891 503 360

Shishe me spërkatëse-pompim, dorëz e gjatë
Përdorim i lehtë: pluhuruesi ergonomik
në dorëz të gjatë
Stabilitet i mirë: formë konike, dizajn kompakt.
Identifikim i qartë: etiketa individuale për të shënuar në to përmbajtjen që keni mbushur.

1 litër | Nr. Art: 0891 503 001



MBROJTJE PERSONALE



Sfungjerë për veshë W51 me lidhëse, 37 db
- Formë plumbi, të prodhuara nga sfungjeri jashtëzakonisht i butë.
- Futen lehtë në kanalin e veshit dhe janë të rehatshme për bartje.
- Pavarësisht se i keni në veshë, ju do të dëgjoni shkëlqyeshëm zërin e njeriut.

Nr. Art: 5899 300 333



Sfungjerë për veshë W51, 37 db
Gjithnjë i mbrojtur: siguri ndaj zhurmës
Gjithnjë dëgjon: pranim i shkëlqyer i zërit të njeriut
Gjithnjë të rehatshme: nuk do ta vëreni se i keni në veshë

Nr. Art: 0899 300 332





Doreza nitrile njëpërdorimëshe
Doreza mbrojtëse njëpërdorimëshe prej vinili. Dorezat janë të papërshkueshme nga uji, nuk kanë papastërti të pudrës dhe mund të vihen në të dy anët. Paketim praktik - 100 copë..

| M | Nr. Art: 0899 460 02
| L | Nr. Art: 0899 460 03
| XL | Nr. Art: 0899 46 04

Doreza nitrile njëpërdorimëshe
Pa pudër - ideale për punë gjatë polirimit.
Doreza mbrojtëse prej nitrili (97% akril-nitril-butadien) për një përdorim të shkurtë. Të papërshkueshme nga uji, nuk kanë papastërti të pluhurit dhe lateksit, ndërsa mund të vëhen në të dy anët. Nuk përmbajnë silikon dhe janë të qëndrueshme në shumë kimikate. Paketim praktik - 100 copë.

| M | Nr. Art: 0899 470 01
| L | Nr. Art: 0899 470 02
| XL | Nr. Art: 0899 470 03



PASTRIM DHE KUJDES PËR DUAR



Mbajtës me pompë për pastën e duarve
Kursen hapësirën: mund të montohet në mur afër lavamanit
Praktik: me të shtypur, pompa nxjerrë pastën në çast.
Precize: dozim optimal me një shtypje të vetme

Nr. Art: 0891 901

Pastë për larje të duarve
E butë: pH-neutrale dhe pa përmbajtje sapuni
E fuqishme: pastron thellë deri në pore dhe parandalon irritimin e lëkurës
E gjithanshme: heqë ndytësitë e mesme-mëdha.
Dermatologjikisht e testuar.

4 litër | Nr. Art: 0893 900 0

Furçë për pastrim të thonjve-duarve
Kompakte: trupi prej druri të dyllosur parandalon humbjen e ngjyrës të shkaktuar nga papastërtia
E fuqishme: heqë edhe papastërtitë më të mëdha
E butë: fijet e prodhuara nga qimet natyrale janë të buta në shtresat e ndjeshme të lëkurës.

Nr. Art: 0891 350 510

PASTRUES DHE AKSESORË PASTRIMI



Solucion për larje të motorit
Efektiv: rezultat i lartë pastrimi
Lehtë i përdorshëm: i butë ndaj materialit dhe veçanërisht i pështatshëm për lëkurën e duarve.

5 litër | Nr. Art: 0893 013 05
20 litër | Nr. Art: 0893 013 20



Pastrues i fortë për disqe të rrotëve
Lidhje e përkryer: nuk rrjedh (nuk derdhet), kështu mundëson veprim optimal të produktit në papastërtinë.
Kujdes i përkryer: i butë ndaj materialit dhe sipërfaqeve
Freski e përkryer: aromë e këndshme, e lehtë.

1 litër | Nr. Art: 0893 476
5 litër | Nr. Art: 0893 476 05



Pastrues i brendshëm për veturë
I gjithashëm: pastron të gjitha pjesët e ngjyrosura dhe plastike, sipërfaqet prej xhami dhe tapicerité.
Lidhet: nuk rrjedhë në sipërfaqet vertikale
Ofron mbrojtje të përkohshme të sipëfaqeve nga pluhuri

500 ml | Nr. Art: 0893 033



IPA Pastrues universal
Për të gjitha pastrimet: universal
Për të gjitha papastërtitë: heq papastërtitë e yndyrshme dhe ato që treten në ujë.
Për shkëlqim pa vija: nuk lë pas shenja ose njolla në sipërfaqet prej xhami

500 ml | Nr. Art: 0893 223 500



Furçë gome
E gjithanshme: Ideale për mbledhje të leshit të kafshëve dhe heqje të pluhurit nga ndenjëset, jastëkëve, lëkurës dhe mbulesave prej stofi

Nr. Art: 0891 350 505



Sfungjer për pastrim të veturës
Rezultat i mirë pastrimi: strukturë me vrima të shumta dhe përmasa të ndryshme të poreve
I përkulshëm: i butë ndaj ngjyrës, sipërfaqe përherë elastike

Nr. Art: 0899 700 400



Sfungjer për pastrim të veturës, i kombinuar
Pamje e përkryer: ideal për pastrim të xhamit të përparmë
Kombinim i përkryer: ana e verdhë pastron zgjyrën e madhe, ndërsa e kafta papastërtinë e imët

Nr. Art: 0899 700 410



Kovë uji
12 litër | Nr. Art: 0695 770 12
20 litër | Nr. Art: 0695 770 20



Leckë mikroaktive për pastrim
Performancë e përkryer: fuqi maksimale pastrimi edhe pa përdorur fare lëndë pastruese
Material i përkryer: përsosmëri maksimale dhe qëndrueshmëri e fortë e fibrave.

e kaltër | Nr. Art: 0899 900 131
e kuqe | Nr. Art: 0899 900 132
e verdhë | Nr. Art: 0899 900 133





Leckë mikroaktive e dyanshme, Profi-DUO
Leckë e thatë mikro-aktive që mund të përdoret e thatë ose e lagur, e cila mbledhë-lidhë mirë papastërtinë.

Nr. Art: 0899 900 138



Leckë mikroaktive për pastrim, PRO GLOSS
Leckë mikro-aktive, që nuk përmban garzë, për shkëlqim pa holograme.

Nr. Art: 0899 900 139



Leckë mikrofil për pastrim dhe polirim
Praktike: pastron pa përdorur lëndë pastruese dhe mbledhë mirë papastërtinë

Nr. Art: 0899 900 050

LECKA PASTRUESE DHE PËR POLIRIM

Microfil, leckë për pastrim dhe polirim
Leckë pastruese që nuk përmban garzë, me aftësi të lartë mbledhëse-thithëse.

Nr. Art: 0899 900 150



Leckë tekstili për polirim
Leckë jashtëzakonisht thithëse për polirim të sipërfaqeve të ndjeshme

150 copë | Nr. Art: 0899 811



Lecka të lagështa për pastrim
Për pastrim të plotë dhe të shpejtë në shumicën e sipërfaqeve, pa ujë, pa sapun dhe pa brushë

90 copë | Nr. Art: 0890 900 90



TAMPON PËR POLIRIM

Tampon polirues, i leshtë
I përshtatshëm për sipërfaqe me ngjyrë të qelë ose të mbyllët.
Akumulim i ulët i nxehtësisë dhe heqje shumë e mirë e papastërtisë.

i bardhë, 195 mm | Nr. Art: 0585 195
i bardhë, 125 mm | Nr. Art: 0585 235
i bardhë, 80 mm | Nr. Art: 0585 23 80

Tampon polirues, i leshtë
Ideal për sipërfaqe me ngjyrë të mbyllët
Akumulim i ulët i nxehtësisë dhe heqje shumë e mirë e papastërtisë.

i zi, 135 mm | Nr. Art: 0585 135

MIRËMBAJTJE DHE MBROJTJE

Mirëmbajtës për gomat izoluese, sprej, 300ml
Gjatë dimrit: parandalon ngrirjen gjatë temperaturave të ulëta
Përkulshmëri: ska më goma poroze dhe të brishta

300 ml | Nr. Art: 0890 110

Dyll mbrojtës
Bonus për përdoruesin: mund të përdoret edhe sipër, falë valvulës 360°
Mbron ngjyrën: rezistent në temperaturë deri +160°C

400 ml | Nr. Art: 0893 082 400

Solucion për shkëlqim
I shpejtë dhe efektiv: brenda pak minutave i jep veturës së vjetër apo të re shkëlqim të lartë.

500 ml | Nr. Art: 0893 011 500
5 litër | Nr. Art: 0893 011 5



Mirëmbajtës për gomat izoluese
Gjatë dimrit: parandalon ngrirjen gjatë temperaturave të ulëta.
Përkulshmëri: ska më goma poroze!

75 ml | Nr. Art: 0893 012 8



MAKINA DHE FSHESA ELEKTRIKE



Fen me ajër të nxehtë, HLG 2000 MASTER
Thjeshtë i lehtë: pajisje e përshtatshme me kontroll kontinual të temperaturës
E besueshme: nxemës qeramike.

Nr. Art: 0702 202 0






Fshesë industriale me vakum, ISS 35 MASTER
Kompakte, për thithje-nxjerrje të papastërtisë.
E përshtatshme për operim me ose pa ujë.
E fuqishme: 1380 W
Gjatësia e kabllos: 7.5 m
Vëllim i madh i rezervuarit: 34 litër
Nr. Art: 0701 137 1

FSHESË ELEKTRIKE PËR TAPICERI

Fshesë elektrike për tapiceri të veturës
Ideale për pastrim të tapicerive dhe ndenjëseve prej stofi në veturë.
Njëkohësisht bën spërkatjen e vendit ku pastroni dhe thithë mbrapa lagështinë duke pastruar dhe terur tapicerinë ash-tuqë mund të shkelet në të pas një kohe shumë të shkurtër.
Falë pompës me fuqi të madhe, ka nivel të ulët të zhurmës, gjithashtu ka sistemin mbrojtës nëse mbetet pa ujë.
E lehtë dhe përshtatshme për bartje.
Dy ndërprerësit e mëdhenj, ai për pompën spërkatëse dhe turbinën thithëse mund të shtypen me këmbë, pra eviton nevojën për tu kërrusur.

Fshesë elektrike për tapiceri, SEG 10 Master
Nr. Art: 0701 1100





Sistemi i spërkatjes dhe thithjes
Rezultat i shkëlqyeshëm i thithjes së papastërtisë krahasuar me produktet e kategorisë së njëjtë të konkurrencës.



Dorëza
Dorëz praktike për transportim të lehtë dhe të thjeshtë. Pipëza opcionale mund të fiksohet në dorezë.



Ndërprerës për këmbë
Turbina thithëse dhe pompa spërkatëse mund të ndërprehen ose aktivizohen me këmbë, pa pasur nevojë të kërruseni.

MBULESA PËR NDENJËSE DHE MBËSHTETËSE

Mbulesa najloni për ndenjëse dhe timon

Të gjitha mbrojtëset nxirren me një shkëputje të vetme.
- Përshtaten në pothuaj të gjitha llojet e veturave.
- Mekanikët do të përmbushin standardet e duhura të pastërtisë.
- Mbulesat janë palosur në kuti kartoni në të cilën nuk depërton pluhuri.
- Puthitje e përkryer dhe veti anti-rrëshqitëse në pjesën e brendshme.
- Mbron dhe mban të pastër brendësinë nga vaji, yndyra, papastërtia etj.

Nr. Art: 0899 500 051
Set i mbulesave për enterier të veturës, 5 në 1









Mbulesë najloni, mbrojtëse për ndenjëse të veturës

Fleksibile: përshtaten në të gjitha llojet e ndenjëseve
Siguri: zmbrapsë ujin dhe vajin
Puthitje: përshtatje optimale falë llastikut mbajtës

Nr. Art: 0899 500 010



WÜRTH PERFECTION LINE

ushqeni pasionin!

Sepse vetëm ata që orvaten me përkushtim për të përkryeren, arrijnë rezultate që lënë përshtypje. Würth Perfection Line do ju ndihmojë të përgatitni veturat në atë mënyrë që klientët do të mbeten gojëhapur.

Shkëlqim i përkryer – për punë shtesë të përkryer.
Rizbuloni pasionin tuaj nga e para për preparatet e veturave – me **Würth Perfection Line!**

Adolf Würth GmbH & Co. KG
74650 Künzelsau, Germany
T +49 7940 15-0
F +49 7940 15-1000
info@wuerth.com

Përfaqësues për Kosovë

Wurth-Kosova Sh.p.k.
Magj. Prishtinë-Ferizaj Km.7
Fsh. Llapnasellë pn.10500, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 600 308
info@wurth-kosova.com

Ne rezervojmë të drejtën për ndryshime në fushën teknike si nevojë e përmirësimit të kualitetit të produkteve, poashtu ndryshimeve në dizajn, model dhe ngjyrë. Ndërsa stoqet ekzistojnë. Ilustrimet mund të jenë shembuj të cilët mund të ndryshojnë në dukje nga artikujt që ju ofrohen / furnizohen. Mund të ketë edhe gabime. Nuk mbajmë përgjegjësi për ndonjë gabim shtypi.